



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 715/3 Prot.

Tiranë, më 29/7/2016

REKOMANDIM

Nr. 17, datë 29/7/2016

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Per Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe neneve 77-97 të Ligjit 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave në ngarkim të kontrolluesit "*Commercee Corp*" Sh.p.k (Shop tv) me Nipt L11518009H), Tiranë

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 159, datë 24.06.2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "*Commercee Corp*" Sh.p.k (Shop tv), me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.

Kontrolluesi "*Commercee Corp*" Sh.p.k (Shop tv) ushtron aktivitet tregtar në fushën e shitjeve direkte të produkteve të ndryshme dhe gjatë aktivitetit përpunon të dhëna për kategoritë e subjekteve të të dhënave klientë dhe punëmarrës. Kontrolluesi përpunon të dhënat e subjekteve të të dhënave "Klientë" nëpërmjet programit informatik "VICIdial". Në programin elektronik "VICIdial" regjistrohen numrat e telefonit për thirrjet dalëse të realizuara nga operatorët e kontrolluesit. Për kryerjen e thirrjeve telefonike dalëse "Outbound", kontrolluesi realizon gjenerimin automatik të numrave të telefonit.

Kontrolluesi ka krijuar një bazë të dhënash në formatin Excel me të dhëna personale të klientëve dhe personave të kontaktuar që përmban: emër, mbiemër, adresë, numër telefoni, gjinia.

Për kategorinë "punëmarrës", kontrolluesi përpunon të dhëna të identifikimit (emër, mbiemër, vendlindje, datëlindje), numrin e sigurimit shoqëror, adresën, numrin personal të identifikimit, nëpërmjet administrimit të dokumenteve në dosjen e punës, për qëllime të menaxhimit të burimeve njerëzore, deklaruar edhe në "formularin e njohimit".

1. Kontrolluesi realizon marketing të drejtpërdrejtë ndaj subjekteve të të dhënave nëpërmjet programit informatik "VICIdial". Përmes këtij programi, operatorët e kontrolluesit marrin në telefon qytetarë të ndryshëm. Programi mundëson regjistrimin zanor të telefonatave, si dhe

ruan gjurmë (log-e) me numrat e subjekteve të të dhënave, datën dhe orën kur janë kontaktuar nga operatorët e kontrolluesit. Programi ruan log-et e telefonatave hyrëse dhe dalëse, që nga fillimi i operimit të tij.

Në ekstraktin e këtyre log-eve (*printscreen-et* administruar në dosjen e hetimit) konstatohet prania e numrave të celularit të subjekteve të të dhënave të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin për t'u kontaktuar nga ky kontrollues sipas nenit 3 pika 24 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, duke vepruar në kundërshtim me nenin 6 pika 1/a të këtij ligji.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ekzistenca e pëlqimit të klientëve është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit, referuar nenit 6 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale. Pëlqimi, në bazë të nenit 3 pika 24 të ligjit, "*duhet të jetë në formën e një deklarate me shkrim, i dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij*". Për sa kohë kontrolluesi nuk ka mundur të provojë ekzistencën e pëlqimit, vlerësojmë se përpunimi i të dhënave është i paligjshëm, duke cënuar edhe parimin e sanksionuar në nenin 5/1/a të ligjit.

2. Zyra e Komisionerit gjatë hetimit administrativ konstatoi se kontrolluesi nuk i informon subjektet e të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.

Programi "Vicial" ruan dhe bisedat telefonike, që realizohen nga punonjësit e kontrolluesit me subjektet e të dhënave. Konstatohet se subjektet e të dhënave të cilët kontaktohen nga operatorët e kontrolluesit nuk informohen lidhur me regjistrimin e bisedës së realizuar gjatë telefonatës.

Në këtë kuadër Zyra e Komisionerit vlerëson se Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

3. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi nuk kishte hartuar një "Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale" në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të klientëve dhe punonjësve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar;

Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbal i konstatimit në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ (që mban datën 12.07.2016). Një kopje e procesverbalit iu dorëzua kontrolluesit.

Në vijim, në datën 21.07.2016 (ora 10:00) u zhvillua seanca dëgjimore në të cilën përfaqësuesi i kontrolluesit paraqiti në formë shkresore pretendimet e kontrolluesit si dhe rregulloren e re për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Kontrolluesi pretendon se sistemi "Vicial" i gjeneron numrat e celularit në formë matematikore dhe në këtë fazë këto numra janë të dhëna anonime të cilat nuk kanë asnjë lidhje me një subjekt të identifikuar apo të identifikueshëm

Zyra e Komisionerit ka konstatuar se gjatë telefonatave të kryera përpunohet dhe një e dhënë tjetër personale "Tingulli" pasi programi "Vicial" ruan dhe bisedat telefonike të kryera.

Në pikën 1 të nenit 3, të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, parashikohet kuptimi i termit e dhënë personale.

"Të dhëna personale" është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social. Ndërsa në pikën 12 të po këtij neni parashikohet se "Përpunim i të dhënave personale" është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.

Në këtë kuadër, përpunimi i të dhënave personale (numër telefoni dhe tinguj) mund ta bëjë lehtësisht të identifikueshëm subjektin e të dhënave nëpërmjet përdorimit të këtyre faktorëve të veçantë të identitetit të tij fizik.

Referuar pretendimeve dhe dokumenteve të paraqitura si provë nga kontrolluesi, Zyra e Komisionerit vlerëson se ky lloj përpunimi (pavarësisht mënyrës së gjenerimit të numrave të telefonit) është i paligjshëm pasi nuk garanton zbatimin e nenit 6 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, duke mos legjitimuar përpunimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin paraprak për t'u kontaktuar.

Në nenin 3 pika 24 e ligjit, parashikohet kuptimi i "pëlqimit" të subjekteve të të dhënave, "Pëlqim i subjekteve të të dhënave" është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij".

Në kushte të tilla Zyra e Komisionerit vlerëson se në cilësinë e kontrolluesit, subjektit "Commercee Corp" Sh.p.k (Shop tv) i lind detyrimi për të plotësuar të gjitha detyrimet ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, të sanksionuara në Ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 29, 30, 31 pika 1/ "a/1" dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 6/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të sigurohet dhe të provohet marrja e pëlqimit paraprak për të gjithë subjektet e të dhënave, të dhënat e të cilëve përpunohen dhe administrohen nga ana juaj në cilësinë e kontrolluesit me qëllim realizimin e marketingut.
2. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të realizohet informimi i subjekteve të të dhënave mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë.
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 2 dhe 3 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni. Pas këtij afati të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi masat e marra në zbatim të Rekomandimit të mbështetura nga aktet përkatëse.
4. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 29/7 /2016

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI